

BANKINGU QENDROR

AKTIVITETET KRYESORE
TË BANKËS SË SHQIPËRISË
korrik - dhjetor 2024



LAJME DHE
NGJARJE
NË 6 MUAJ

Nr. 16





Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko.

EDITORIAL: BANKINGU I HAPUR

Të nderuar Lexues,

Me kënaqësi ju paraqesim numrin e ri të Revistës "Bankingu Qendror: lajme dhe ngjarje në gjashtë muaj" për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024. Ky numër sjell në vëmendjen tuaj veprimtaritë e realizuara gjatë periudhës, duke pasqyruar përpjekjet dhe hapat që kemi ndërmarrë për të përmbushur objektivat tanë më të rëndësishëm, me fokus në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e përgjithshme të vendit.

Ky gjashtëmujor ka shënuar një zhvillim të rëndësishëm në fushën e pagesave në tregun shqiptar. Në një botë gjithnjë e më të digjitalizuar, bankingu i hapur është një koncept që po ndryshon rrënjësisht mënyrën se si qytetarët ndërveprojnë me financat e tyre. Ky model i ri bankar u mundëson individëve të aksesojnë të dhënat e llogarive të tyre dhe të realizojnë pagesa përmes palëve të treta, si institucione financiare të tjera të ndryshme nga bankat. Në këtë mënyrë, klientët nuk janë të kufizuar vetëm te bankat ku kanë llogaritë e tyre, por mund të përdorin ofrues alternativë shërbimesh për të menaxhuar financat në mënyrë më të shpejtë, të thjeshtë dhe me kosto më të ulët.

Ky ndryshim në praktikën bankare u bë i mundur pas miratimit të një direktive të veçantë nga Bashkimi Evropian në vitet 2018-2019, një akt ligjor që krijoi mundësinë e përfshirjes së ofruesve të shërbimeve si palë të treta në proceset e pagesave dhe menaxhimit të llogarive.

Banka e Shqipërisë ka qenë një nga institucionet pioniere në rajon që ka përqafuar këtë transformim, duke e bërë atë realitet edhe

në vendin tonë. Ajo ka punuar intensivisht për të përgatitur kuadrin ligjor dhe rregullator për të mbështetur këtë inovacion, i cili është prezantuar për herë të parë në tregun shqiptar përmes ligjit 55/2020 "Për shërbimet e pagesave".

Në vitin 2024, Banka e Shqipërisë licenoi institucionin e parë financiar për bankingun e hapur, një hap i rëndësishëm ky për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit financiar shqiptar. Një aspekt thelbësor i bankingut të hapur është se e vendos fokusin te qytetari. Ky koncept synon të ofrojë më shumë zgjedhje dhe shërbime më të shpejta e më të thjeshta për kryerjen e pagesave dhe transfertave, duke i bërë ato më të lehta dhe më të sigurt për të gjithë qytetarët.

Banka e Shqipërisë fton institucionet financiare të aplikojnë për t'u pajisur me licencën e bankingut të hapur, me qëllim zgjerimin e shërbimeve alternative që mund të përmirësojnë aktivitetet financiare të përditshme të shqiptarëve.

Implementimi i bankingut të hapur është vetëm hapi i parë drejt krijimit të një sistemi të financave të hapura (open-finance), ndaj Banka e Shqipërisë inkurajon bankat të orientohen më shumë drejt projekteve inovative. Kjo nënkupton që në të ardhmen, ky proces do të mundësojë digjitalizimin e kredidhënies, investimeve dhe shërbimeve të tjera financiare, duke i sjellë një përfitim të madh qytetarëve dhe ekonomisë në tërësi. Ky është një hap i rëndësishëm për modernizimin e sistemit tonë financiar dhe përqafimin e tendencave më të fundit globale të digjitalizimit financiar.

ZHVILLIMET KRYESORE

SHQIPËRIA, ZYRTARISHT ANËTARE E SEPA-S

Shqipëria është zyrtarisht anëtare e zonës gjeografike SEPA (Single Euro Payments Area) që nga 21 nëntori 2024, pas miratimit të kërkesës nga Bordi i Këshillit Evropian të Pagesave. Ky anëtarësim është një hap i rëndësishëm në kuadër të integritit evropian të Shqipërisë dhe e vendos atë në grupin e parë të vendeve të Ballkanit Perëndimor që bashkohen me SEPA-n. Guvernatori Sejko e vlerësoi këtë si një moment historik që reflekton përpjekjet dhe angazhimin e institucioneve, sektorit financiar dhe partnerëve vendas për të përmbushur standardet evropiane.

Ky anëtarësim pritet të ketë përfitime të dukshme ekonomike për Shqipërinë. Kostoja e pagesave ndërkufitare me vendet anëtare të SEPA-s do të ulet ndjeshëm, duke arritur kursime të paktën 20 milionë euro në vitin e parë. Gjithashtu, do të rritet konkurrenca dhe do të mundësohet prezantimi i produkteve dhe shërbimeve moderne dhe të sigurta. Pjesëmarrja në SEPA do të ndikojë pozitivisht edhe në fusha të tjera si tregtia, turizmi, remitancat dhe investimet direkte, duke sjellë një përfitim të konsiderueshëm për ekonominë shqiptare në afat të mesëm. Projeksionet vlerësojnë se në afat të mesëm, ekonomia shqiptare do të përfitojë disa qindra milionë euro nga anëtarësimi në SEPA.

Puna për anëtarësimin e Shqipërisë në SEPA ka filluar që në vitin 2021, kur Banka e Shqipërisë u bë pjesë e projektit rajonal për modernizimin e sistemeve të pagesave. Aplikimi zyrtar i Shqipërisë për anëtarësim u firmos më 12 qershor 2024 dhe, pas një pune të përbashkët dhe koordinimi me institucionet përkatëse, Shqipëria u bë vendi i parë në rajon që dërgoi aplikimin, i cili tani është finalizuar me sukses.



PËRFAQËSUESIT E BANKËS QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS VIZITONË BANKËN E SHQIPËRISË **5 korrik 2024, Tiranë**

Në datën 5 korrik 2024, disa përfaqësues nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës të kryesuar nga Kryetarja e Komitetit të Auditimit, Zj. Nora Latifi Jashari, dhe anëtarë të tjerë të lartë nga auditimi i brendshëm, zhvilluan një vizitë pune pranë Bankës së Shqipërisë. Ky takim u realizua me qëllim shkëmbimin e eksperiencave midis dy institucioneve, si dhe thellimin e bashkëpunimit në fushën e auditimit të brendshëm.



Delegacioni zhvilloi takime të veçanta pune dhe diskutime me Inspektoren e Përgjithshme të Bankës së Shqipërisë, zj. Merita Bejtja, anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës dhe njëkohësisht Kryetaren e Komitetit të Auditimit të Bankës së Shqipërisë, zj. Suela Popa, si dhe përfaqësues të tjerë nga Banka e Shqipërisë.

Disa nga temat kryesore të diskutuara gjatë takimit ishin roli i Komitetit të Auditimit në institucionin e Bankës Qendrore dhe rëndësia e tij në sigurimin e pavarësisë së Auditimit të Brendshëm; Auditimi i Brendshëm si hallkë e rëndësishme në vlerësimin e sistemit të kontrollit të institucionit, politika e auditimit të brendshëm dhe standardet ndërkombëtare të zbatuara në realizimin e objektivave; njësia e Administrimit të Rrezikut Operacional në

menaxhimin e rreziqeve, si dhe bashkëpunimi i tij me Auditimin e Brendshëm.

WORKSHOPI "NAVIGIMI I RREZIQEVE TË NDËRLIDHURA: NDIKIMET E DEGRADIMIT MJEDISOR DHE NDRYSHIMEVE KLIMATIKE" **11 korrik 2024, Tiranë**

Më 11 korrik 2024, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me CETEx në London School of Economics, organizoi një workshop mbi ndikimet e degradimit mjedisor dhe ndryshimeve klimatike. Aktiviteti mbledhi përfaqësues nga institucione publike dhe private për të diskutuar sfidat dhe implikimet e klimës në ekonomi dhe financa, me qëllim kryesor përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në një dialog mbi sfidat që paraqiten nga ndryshimi i klimës dhe implikimet e saj në ekonomi dhe financa.



FjalakryesoreumbajtngaZëvendësguvernatorja e Bankës së Shqipërisë, znj. Natasha Ahmetaj, e cila paraqiti një pasqyrë të Strategjisë së Gjellbër të Bankës së Shqipërisë, të hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore, në linjë me objektivat globale për një ekonomi dhe sisteme financiare të qëndrueshme. Ajo theksoi rëndësinë e rolit të sektorit financiar për një qasje të guximshme ndaj këtyre objektivave, duke mbështetur progresin teknologjik dhe inovacionin. Kjo kërkon së pari përfshirje të rreziqeve të ndryshimit të klimës në analizat e ekspozimit të sektorit financiar, duke e konsideruar stabilitetin financiar si parakusht për tranzicionin e gjellbër.



Workshopi u përmbyll duke theksuar domosdoshmërinë e përfshirjes aktive dhe koordinimit të gjithë aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë në adresimin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme.

GUVERNATORI SEJKO NË TAKIMIN PËRMBYLLËS ME PËRFAQËSUESIT E MISIONIT TË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

12 korrik 2024, Tiranë

Më 12 korrik 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, zhvilloi takimin

përmbyllës me misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të kryesuar nga zj. Anke Weber, shefe e Misionit të FMN-së për Shqipërinë.



Gjatë takimit, Guvernatori Sejko diskutoi lidhur me qëndrueshmërinë e sektorit bankar, i cili paraqet tregues të stabilizuar apo në përmirësim të kapitalit, të likuiditetit dhe të përfitueshmërisë. Në vijim, ai shtoi se normalizimi gradual dhe i kujdesshëm i qëndrimit të politikës monetare gjatë periudhës 2022 – 2023 bëri të mundur reduktimin e presioneve inflacioniste, pa dëmtuar perspektivat afatmesme të rritjes ekonomike.



Nga ana e saj, shefja e Misionit të FMN-së konfirmoi se politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka pasur një ndikim pozitiv në ruajtjen e ekuilibrave monetarë e financiarë të vendit. Zj. Weber shtoi se progresi i mëtejshëm i reformave financiare do të sofistikojë më tej strukturën mbikëqyrëse dhe rregullatore, duke nxitur zhvillimin e tregjeve financiare, fuqizuar mbrojtjen e konsumatorit,



si dhe garantuar mbrojtjen e sistemit bankar. Ajo theksoi se mosçenimi i pavarësisë së institucionit të Bankës së Shqipërisë mbetet në çdo rast një parakusht esencial për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe të stabilitetit financiar të vendit.

Në mbyllje, të palët theksuan rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm të situatës ekonomike dhe financiare, si dhe të koordinimit të kujdesshëm të politikave nga autoritetet shqiptare, duke marrë masat e nevojshme në kohën e duhur.

GUVERNATORI SEJKO NË KOMISIONIN PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET EUROPIANE 17 korrik 2024, Tiranë

Më 17 korrik 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Komisionin Parlamentar për Çështjet Europiane në lidhje me përgatitjen e institucioneve shqiptare për Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA). Në fillim të fjalës së tij, Guvernatori Sejko falënderoi deputetët e Komisionit për mundësinë e krijuar për të ndarë punën voluminoze të Bankës së Shqipërisë, për hedhjen e një hapi të rëndësishëm drejt integritimit ekonomik të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke theksuar se finalizimi me

sukses i tij do të përfitojë nga mbështetja e të gjitha institucioneve shtetërore të përfshira në proceset integruese.

Në fushën e pagesave, Shqipëria tregon një pajtueshmëri të lartë ligjore me acquis dhe me kuadrin rregullator të SEPA-s, falë: miratimit në vitin 2018, të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe të kuadrin rregullator për zbatimin e tij; miratimit të një rregulloreje të re që transponon të ashtuquajturën rregullore të SEPA-s; dhe daljes nga “lista gri” sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Përtej rëndësisë politike në kuadër të integritimit evropian të vendit, pjesëmarrja në SEPA ka një sërë përfitimesh të konsiderueshme për konsumatorin, bizneset dhe ekonominë shqiptare.



Në vijim, Guvernatori u shpreh se një projekt tjetër mjaft i rëndësishëm i lidhur me SEPA-n, por dhe me tregun e brendshëm të pagesave, është ai i zbatimit të infrastrukturës për pagesat e shpejta. Ai shtoi se aktualisht jemi në komunikim me Bankën e Italisë për të adoptuar një sistem që do të jetë identik me sistemin e pagesave të shpejta që operon Banka Qendrore Evropiane. Në këtë mënyrë, sistemi që synojmë të adoptojmë do të jetë në përputhje me SEPA-n dhe me sistemet e tjera që operojnë në BE.

GUVERNATORI SEJKO PREZANTON RAPORTIN VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2023 NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

18 korrik 2024, Tiranë

Në datë 18 korrik 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Sejko, paraqiti Raportin Vjetor për vitin 2023 përpara deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Ai theksoi se ky vit kishte qenë një periudhë konsolidimi për ekonominë shqiptare, duke përmirësuar ekuilibrat ekonomikë dhe financiarë, përkundër sfidave të jashtme. Aktiviteti ekonomik u rrit me 3.5%, punësimi me 2.2%, dhe paga mesatare u rrit me 1.3%. Inflacioni ra nga 7.4% në fillim të vitit në 4% në fund, duke reflektuar përmirësimin e besimit të bizneseve dhe familjeve, si dhe zgjerimin e kredisë bankare.



Në vijim, Guvernatori bëri një pasqyrë të aktiviteteve të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2023, duke përfshirë rritjen e normës bazë të interesit dhe rritjen e kreditimit të normave të interesit për sektorin privat, që arritën në 14%. Ai gjithashtu theksoi dy arritje të rëndësishme: daljen e Shqipërisë nga lista gri e FATF dhe fillimin e procedurave për marrjen e statusit të ekuivalencës së kuadrit tonë mbikëqyrës e rregullator me standardet e Bashkimit Evropian, çka do të mundësojë rritjen e kreditimit në ekonomi nga bankat evropiane. Guvernatori vlerësoi gjithashtu arritjet e Bankës



në rritjen e efikasitetit të pagesave dhe nismat për integrimin e Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA), si pjesë e planit të rritjes për Ballkanin Perëndimor.

Në përmbyllje, Guvernatori e përmbledhi aktivitetin e Bankës së Shqipërisë si një përpjekje të vazhdueshme për të përmbushur angazhimet strategjike dhe ligjore, duke respektuar rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2023, dhe theksoi se kjo filozofi do të vazhdojë të udhëheqë punën e institucionit edhe në vitin 2024.

GUVERNATORI SEJKO ZHVILLON NJË TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E MOODY'S

3 shtator 2024, Tiranë

Më 3 shtator 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, zhvilloi një takim me një delegacion nga Moody's Analytics. Gjatë takimit, Guvernatori Sejko u shpreh se ekonomia shqiptare ka pasur një ecuri pozitive, pavarësisht sfidave të shumta dhe serioze me të cilat është përballur gjatë viteve të fundit. Ai theksoi se Shqipëria gëzon një rritje ekonomike solide, inflacion të ulët dhe nën kontroll, si dhe përmirësim të ekuilibrave të brendshëm dhe të jashtëm të vendit.



Ekonomia shqiptare pritet të vijojë të rritet në afatin e mesëm, me norma të qëndrueshme dhe pranë potencialit, ndërkohë që inflacioni

pritet të qëndrojë pranë niveleve aktuale për pjesën e mbetur të vitit dhe të kthehet në objektiv gjatë gjysmës së parë të vitit 2025. Banka e Shqipërisë është e angazhuar në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit bankar, nëpërmjet garantimit të një rregullimi dhe mbikëqyrjeje të kujdesshme të tij. Ajo ofron gjithë mbështetjen e saj për integrimin evropian dhe ndjekjen me rigorozitet të reformave që imponon ky proces.



Më 19 prill 2024, Agjencia ndërkombëtare e vlerësimit të kredibilitetit "Moody's Rating"- e cila është e ndarë nga dega "Moody's analytics"- ndryshoi perspektivën e Shqipërisë, nga "e qëndrueshme" në "pozitive".

MBI TAKIMIN E GUVERNATORIT SEJKO ME PËRFAQËSUESIN E ZYRËS SË BB-SË NË SHQIPËRI

18 shtator 2024, Tiranë

Në datën 18 shtator 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, zhvilloi një takim pune me z. Emanuel Salinas, përfaqësues i Zyrës së Bankës Botërore (BB) në Shqipëri.

Në krye të takimit, Guvernatori kreu një ekspozë të panoramës ekonomike në

vend të fokusuar në stabilitetin financiar, rritjen ekonomike, ecurinë e kreditimit dhe depozitave. Gjithashtu, ai diskutoi lidhur me një ndër objektivat strategjike të Bankës së Shqipërisë si modernizimi i sistemeve të pagesave dhe më konkretisht anëtarësimi në Tregun Unik të Pagesave në Euro, njohur ndryshe si SEPA, dhe zbatimi i projektit për pagesat e shpejta (Instant Payment), për të cilin Banka e Shqipërisë po bashkëpunon ngushtë me ekspertët e Bankës së Italisë. Në këtë kuadër, Banka Botërore mund të luajë një rol mbështetës për këtë projekt me rëndësi strategjike për Bankën e Shqipërisë dhe zhvillimin e pagesave në vend.



Një tjetër prioritet i Bankës së Shqipërisë këtë periudhë, në të cilën angazhimi i Bankës Botërore mbetet i një rëndësie të veçantë, ka qenë përmirësimi i kuadrit rregullativ për sistemin financiar sidomos në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e interesave më të mira të konsumatorëve përballë zhvillimeve të vazhdueshme të këtij tregu.



Z. Salinas përgëzoi Guvernatorin Sejko për angazhimin e shfaqur gjatë zbatimit me sukses të projekteve të përbashkëta dhe u shpreh se Banka Botërore do të vijojë të angazhohet që programet e asistencës teknike dhe bashkëpunimit ndërinstitucional të thellohen edhe më tej.

GUVERNATORI SEJKO NË 20 VJETORIN E BANKËS RAIFFEISEN NË SHQIPËRI **26 shtator 2024, Tiranë**

Në datën 26 shtator 2024, Guvernatori Sejko mori pjesë në ceremoninë e organizuar nga Banka Raiffeisen, me rastin e 20-vjetorit të saj në Shqipëri. Gjatë fjalës përshëndetëse, Guvernatori uroi në emër të Bankës së Shqipërisë bordin, menaxhimin e bankës dhe stafin, për arritjen e këtij momenti të rëndësishëm. Ai vlerësoi rolin që ka luajtur Raiffeisen Bank në zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Pas 20 vitesh në treg, Raiffeisen Bank vijon të jetë një nga tre bankat më të mëdha në vend, duke gëzuar besimin e depozituesve dhe investitorëve, të cilët e shohin këtë bankë si partnerin e tyre strategjik për t'i besuar kursimet dhe zhvillimin e biznesit.



Më tej, ai shtoi se duhet të vlerësojmë dhe rolin e Raiffeisen përtej veprimtarisë bankare. Si themelues i Fondit të parë të Investimeve, si dhe aktivitetit në tregun e pensioneve private vullnetare, Banka Raiffeisen ka qenë gjithnjë



mbështetëse e zhvillimeve të tregut të kapitalit dhe një partner i rëndësishëm në projektet e zhvillimit ekonomik.

GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN E ORGANIZUAR NGA BANKA POPULLORE E MAQEDONISË SË VERIUT DHE KOMITETI BRETTON WOODS 1 tetor 2024, Shkup

Në datën 1 tetor 2024, Guvernatori Sejko mori pjesë në Konferencën e nivelit të lartë të organizuar nga Banka Popullore e Maqedonisë së Veriut dhe Komiteti Bretton Woods, me temë "Bankat qendrore dhe bankingu qendror në një botë shumë komplekse: Demonstrimi i përkushtimit dhe ruajtja e besueshmërisë". Panelet e konferencës diskutuan lidhur me çështje të tilla si: pavarësia e bankave



qendrore, si një shtyllë kyçe e ekonomisë moderne politike; perspektiva mbi mandatet e bankave qendrore; financat përfshirëse gjinore në rajonin e EJT-së; dhe vlerësimi i episodit më të fundit të krizës dhe mësimet e nxjerra.



Në këtë konferencë, Guvernatori Sejko ishte pjesë e panelit me temë "Perspektiva mbi mandatet e bankave qendrore dhe kompromiset e politikave", në të cilin u trajtuan sfidat e reja lidhur me këtë çështje dhe ndërveprimi i tyre me objektivat e bankave qendrore. Guvernatori prezantoi progresin e kryer nga Banka e Shqipërisë në kuadër të procesit të integritimit evropian, veçanërisht në fusha si ajo e mbikëqyrjes bankare dhe e sistemeve të pagesave. Ai u ndal në reformat dhe nismat e ndërmarra lidhur me zhvillimin dhe modernizimin e sistemeve të pagesave, me synim përafrimin e mëtejshëm të tyre me sistemin e pagesave të Eurozonës (SEPA).



Guvernatori Sejko zhvilloi gjithashtu takime me z. Alfred Kammer Drejtorin e Departamentit

Evropian në FMN dhe z. Sebastian Sosa, Rezident Rajonal për Ballkanin Perëndimor të FMN-së, ku u diskutuan sfidat me të cilat po përballet ekonomia globale dhe ajo shqiptare në veçanti, si dhe ecuria e projekteve të përbashkëta në kuadër të asistencës teknike që FMN-ja ofron për Shqipërinë.

SHKOLLA RINORE PËR EDUKIMIN FINANCIAR 5-6 tetor 2024, Tiranë

Në datat 5-6 tetor 2024, në ambientet e selisë nr. 2 të Bankës së Shqipërisë u organizua “Shkolla Rinore për Edukimin Financiar”, me pjesëmarrjen e rreth 60 të rinjve gjimnazistë nga qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. Aktiviteti dyditor u organizua në kuadër të nismës së Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e edukimit financiar në arsimin parauniversitar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Bankën e Shqipërisë dhe aktorë të tjerë. Programi edukues synoi t’i ndihmojë të

rinjtë të përvetësojnë aftësi të qëndrueshme financiare.



Gjatë fjalës së tij, Guvernatori u shpreh se angazhimi i Bankës së Shqipërisë në fushën e edukimit financiar ka nisur herët dhe ka pasur një rritje konstante, me një gamë të gjerë produktesh e programesh edukative dedikuar grup-moshave të ndryshme, e kryesisht brezit të ri. Ai shtoi se edukimi financiar luan një rol të rëndësishëm në jetën e një të riu, duke i ofruar atij njohuri dhe aftësi të rëndësishme, që i vijnë në ndihmë për menaxhimin efektiv të parave të tij si dhe i zhvillojnë një ndjenjë përgjegjësie dhe llogaridhënieje sa i përket financave.



Ministrja Muzhaqi theksoi se: “Edukimi financiar për fëmijët dhe të rinjtë është shumë më tepër se thjesht njohuri mbi buxhetin dhe kursimin, ai përfaqëson një themel të rëndësishëm për të ndërtuar të ardhmen e tyre në një botë gjithnjë e më digjitale”.

GUVERNATORI SEJKO PRET NË TAKIM GUVERNATORIN E BANKËS KOMBËTARE TË AUSTRISË

7 tetor 2024, Tiranë

Më 7 tetor 2024, Guvernatori i Bankës Kombëtare të Austrisë, Robert Holzmann, zhvilloi një vizitë zyrtare në Bankën e Shqipërisë, duke shënuar një moment të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko vlerësoi mbështetjen e Austrisë në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë.



Guvernatori Sejko e informoi Guvernatorin Holzmann mbi zhvillimet më të fundit makroekonomike të Shqipërisë, përfshirë qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe reformat e ndërmarra në kuadër të forcimit të stabilitetit financiar. Një çështje e rëndësishme e diskutimit ishte ndikimi i euroizimit në politikën ekonomike dhe masat e marra nga Banka e Shqipërisë për të rritur përdorimin e monedhës kombëtare. Po ashtu, vëmendje mori edhe modernizimi i sistemeve të pagesave dhe

anëtarësimi i Shqipërisë në SEPA në kuadër të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor.



Në kuadër të kësaj vizite zyrtare, Banka e Shqipërisë organizoi gjithashtu një tryezë me përfaqësues të sistemit bankar dhe drejtues të lartë të Bankës së Shqipërisë, ku u diskutuan zhvillimet më të fundit ekonomike, inflacioni në rajon dhe BE, si dhe çështje të tjera me rëndësi për sistemin bankar si masat mbikëqyrëse dhe rregullatore të vendosura nga Banka Qendrore Evropiane dhe modernizimi i sistemeve të pagesave në vend.

GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN KOMBËTARE TË SIGURISË KIBERNETIKE

10 tetor 2024, Tiranë

Më 10 tetor 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Konferencën Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, të organizuar nga Autoriteti Kombëtar



për Sigurinë Kibernetike, ku morën pjesë ministra, përfaqësues diplomatikë, partnerë ndërkombëtarë, përfaqësues nga sektori privat dhe ekspertë të sigurisë kibernetike.



Guvernatori Sejko prezantoi strategjitë që ndjek Banka e Shqipërisë për një hapësirë të sigurt kibernetike. Një ndër objektivat kryesorë të zhvillimit në Bankën e Shqipërisë është modernizimi dhe siguria e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë zgjerimin e funksionaliteteve dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sistemeve. Në fokus gjithashtu mbetet optimizimi i infrastrukturës së rrjetit përmes teknologjive të reja për mbrojtjen e mjedisit dhe eficiencës në energji, dhe forcimi i sigurisë përmes përmirësimit të planeve të vijimësisë dhe reagimit ndaj rreziqeve kibernetike, mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira për mbrojtjen kibernetike.

Banka e Shqipërisë po vijon punën për forcimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrjen e rrezikut të teknologjisë së informacionit. Nga ana e

bankave janë kryer investime të konsiderueshme për mbrojtjen kibernetike gjatë viteve të fundit, të cilat synojnë të mbrojnë bankat nga sulmet kibernetike dhe të rrisin sigurinë e të dhënave dhe infrastrukturës IT.

GUVERNATORI SEJKO PRET SHEFIN E SEKTORIT EKONOMIK RAJONAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR NË AMBASADËN E REPUBLIKËS FRANCEZE 16 tetor 2024, Tiranë

Në datën 16 tetor 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, zhvilloi një takim me Shefin e Sektorit Ekonomik Rajonal për Ballkanin Perëndimor, pranë Ambasadës së Republikës Franceze, z. Pierre Grandjovan, rezident në Beograd.



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë prezantoi z. Pierre Grandjoun me zhvillimet ekonomike në vend, ku theksoi se rritja ekonomike është në trajektore pozitive zhvillimi dhe balancat kryesore ekonomike pritet të forcohen në vitet e ardhshme. Guvernatori Sejko u shpreh se: inflacioni ka ardhur në rënie të shpejtë, duke shënuar dhe një rikuperim të plotë nga goditja që solli rritjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare; sistemi financiar karakterizohet nga nivele të kënaqshme kapitalizimi dhe likuiditeti; sektori bankar ka shënura rritje të kreditimit dhe përmirësim të treguesit të kredive me probleme.

Z. Grandjoun shprehu vlerësimet e tij për kontributin e vazhdueshëm që Banka e Shqipërisë jep në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit. Në vijim, ai e uroi Guvernatorin Sejko për hapjen zyrtare të negociatave për Grup-Kapitujt me Bashkimin Evropian, duke e cilësuar atë si një moment historik në rrugëtimin e Shqipërisë në procesin e integritimit me BE-në.

Në përfundim, palët biseduan mbi perspektivat për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve, nëpërmjet projekteve potenciale në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

MBI TAKIMET E GUVERNATORIT SEJKO GJATË ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE VJETORE TË FMN-BB 24 -27 tetor 2024, Uashington DC, SHBA

Në datat 24 -27 tetor 2024, në Uashington DC, SHBA, u zhvilluan Mbledhjet Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB). Banka e Shqipërisë u përfaqësua në këto takime me një delegacion të kryesuar nga Guvernatori, z. Gent Sejko, Zëvendësguvernatorja e Parë, zj. Luljeta Minxhozi, si dhe drejtues të tjerë.



Me këtë rast, Guvernatori Sejko zhvilloi disa takime të niveli të lartë me personalitete të rëndësishme të fushës, përfaqësues të këtyre dy organizmave financiare ndërkombëtare.





Guvernatori Sejko i njohu përfaqësuesit e FMN-së dhe BB-së me zhvillimet ekonomike dhe perspektivat e progresit të mëtejshëm të vendit. Ai u shpreh se, ashtu si vendet e tjera, edhe Shqipëria u prek nga goditjet e pafavorshme ekonomike globale dhe inflacioni i lartë. Në këtë kuadër, politika e ndjekur nga Banka e Shqipërisë si autoriteti monetar i vendit ka qenë e mbështetur plotësisht në të dhëna transparente dhe i është komunikuar në mënyrë efektive aktorëve vendas. Aktualisht, inflacioni në vend është i ulët krahasuar me vendet e rajonit dhe ato të



BE-së, duke reflektuar kështu një normë më të ulët inflacioni të përgjithshëm. Kjo ka ardhur si rezultat i politikës monetare të kujdeshme të Bankës së Shqipërisë, si dhe i presioneve inflacioniste të shkaktuara nga mbiçmimi i kursit të këmbimit.



Përfaqësuesit e FMN-së dhe BB-së përgëzuan Shqipërinë për progresin e bërë në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe veçanërisht për çeljen e negociatave me Bashkimin Evropian për grup-kapitullin e parë. Ata gjithashtu u ndalën

në vlerësimin e përmirësuar nga Agjencia prestigjioze Ndërkombëtare e Vlerësimit Moody's, e cila e rishikoi me rritje ekonominë shqiptare, duke e konsideruar në Ba3- e qëndrueshme, nga B1-pozitive.

Një vlerësim i veçantë u shpreh nga ana e tyre edhe sa i përket reformave të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar në vend dhe stabilitetit të çmimeve, të cilat sipas përfaqësuesve të këtyre institucioneve mbeten mandati dhe objektivi kryesor i Bankës.

GUVERNATORI SEJKO NË SEANCËN DËGJIMORE TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR

30 tetor 2024, Tiranë

Më 30 tetor 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, mori pjesë në Komisionin e Posaçëm për luftën kundër dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja në proceset demokratike. Ai prezantoi punën e Bankës së Shqipërisë për transparencën dhe komunikimin me publikun, duke theksuar rëndësinë e besimit dhe informimit të saktë si shtylla thelbësore të një institucioni të pavarur. Guvernatori vuri në dukje se dezinformimi, i përhapur përmes zhvillimeve teknologjike, mund të dëmtojë stabilitetin e institucioneve financiare dhe besimin e qytetarëve të sistemi



bankar. Ai theksoi se përhapja e informacionit të rremë mund të ndikojë në vendimmarrjen e publikut dhe të cenojë sigurinë e tregjeve financiare.

Gjithashtu, Guvernatori trajtoi sfidat e sigurisë kibernetike, duke vënë theksin te rritja e kërcënimeve ndaj institucioneve financiare dhe bankave. Ai shpjegoi se për të mbrojtur të dhënat dhe sistemet financiare, janë ndërmarrë masa teknologjike dhe organizative që forcojnë mbrojtjen ndaj sulmeve kibernetike. Si rezultat i këtyre masave, asnjë nga sulmet me të cilat jemi përballur nuk është materializuar apo ka shkaktuar pasoja të rënda në subjektet banka dhe jobanka.

Në përfundim, Guvernatori Sejko garantoi mbështetjen e Bankës së Shqipërisë për këtë nismë dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me Komisionin.

GUVERNATORI SEJKO NË PROMOVIMIN E LIBRIT “INSTITUCIONET E BRETTON WOODS-IT DHE SHQIPËRIA” NGA AKAD. PROF. DR. ANASTAS ANGJELI 31 tetor 2024, Tiranë

Më datë 31 tetor, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në promovimin e veprës më të fundit të profesorit dhe akademikut të shquar z. Anastas Angjeli, me titull “Institucionet e Bretton Woods-it dhe Shqipëria”. Ky libër ofron një përshkrim të plotë dhe interesant të rolit që institucionet ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB) dhe Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) kanë luajtur në stabilizimin dhe prosperitetin e ekonomisë sonë. Libri paraqet rrugëtimin historik dhe bashkëpunimin e Shqipërisë me FMN-në, BB-në dhe OBT-në, duke i ilustruar me shembuj konkretë dhe të prekshëm.



Guvernatori u shpreh se institucionet, pavarësia, profesionalizmi, roli dhe rëndësia e tyre evidentohen jo vetëm si ura lidhëse ndërmjet institucioneve ndërkombëtare dhe ekonomisë shqiptare, por edhe si një faktor thelbësor i stabilitetit ekonomik e financiar të vendit. Ai theksoi se Banka e Shqipërisë i mishëron plotësisht këto karakteristika dhe është një shtyllë e rëndësishme e stabilitetit



ekonomik e financiar të vendit, duke luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe nxitjen e tregut financiar, qëndrueshmërinë dhe rezistencën e tij, si dhe përfshirjen financiare të popullatës. Mbi të gjitha, Banka e Shqipërisë jep një kontribut të rëndësishëm në stabilitetin e çmimeve, i cili përbën objektivin kryesor të saj.

Në përfundim të fjalës së tij, Guvernatori falenderoi Profesor Angjelin për këtë libër të ri, i cili paraqet një histori të pasuruar me fakte dhe konkluzione interesante për ekonominë dhe financën.

BANKA E SHQIPËRISË NË BASHKËPUNIM ME SHOQATËN SHQIPTARE TË BANKAVE ORGANIZOJNË KONFERENCËN VJETORE ME TEMË: “ROLI I BANKËS QENDRORE DHE SISTEMIT BANKAR NË RRUGËN DREJT BE-SË”

13 nëntor 2024, Tiranë

Më 13 nëntor 2024, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, organizoi konferencën vjetore me temë “Roli i bankës qendrore dhe sistemit



bankar në rrugën drejt BE-së". Konferenca u përshëndet nga figura kyçe të shtetit dhe sektorit bankar, përfshirë Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, Presidentin e Shoqatës Shqiptare të Bankave, z. Bledar Shella, dhe përfaqësues të tjerë të lartë të Qeverisë Shqiptare. Në fjalën e tij, Guvernatori Sejko theksoi se viti 2024 do të mbahet mend si viti kur Shqipërisë iu dha "drita jeshile" për nisjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Shqipëria ka arritur progres të rëndësishëm ekonomik, duke rritur vëllimin e aktivitetit ekonomik dhe ulur

papunësinë e borxhin publik. Gjithashtu, sektori bankar ka shfaqur qëndrueshmëri të jashtëzakonshme, me një rënie të kredive me probleme dhe përmirësim të treguesve financiarë. Guvernatori theksoi se ky sukses nuk ka qenë i rastësishëm, por rezultat i politikave makroekonomike të koordinuara dhe reformave strukturore, të cilat janë ndihmuar nga Banka e Shqipërisë dhe sektorit bankar. Ai gjithashtu vuri në dukje rëndësinë e modernizimit të platformave të pagesave dhe përpjekjeve për përfshirjen financiare të qytetarëve, si një investim të rëndësishëm për zhvillimin afatgjatë të vendit.





Konferenca u zhvillua në tri sesione, ku u diskutuan sfidat dhe mundësitë për përafrimin e politikave monetare me ato të BE-së, transformimi digjital i sektorit bankar dhe roli i bankingu digjital për rritjen ekonomike, si dhe përpjekjet për një integrim të suksesshëm të Ballkanit Perëndimor në BE. Në përfundim të saj, u bë një përmbledhje e sfidave dhe mundësive që paraqiten në rrugën e Shqipërisë drejt BE-së.

GUVERNATORI SEJKO ZHVILOI NJË TAKIM ME MISIONIN E FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR 14 nëntor 2024, Tiranë

Më 14 nëntor 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, zhvilloi një takim me misionin e Fondit Monetare Ndërkombëtar (FMN), të kryesuar nga zj. Anke Weber, shefe e Misionit për Shqipërinë. Qëllimi i



vizitës së Misionit në Shqipëri është mbajtja e bisedimeve me autoritetet shqiptare në kuadër të Artikullit IV.



Fillimisht, Guvernatori Sejko i njohu bashkëbiseduesit me zhvillimet më të fundit në ekonominë vendase, ku theksoi se treguesit kryesorë të stabilitetit ekonomik, monetar e financiar të saj, janë në një trend pozitiv zhvillimi.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e FMN-së shprehën vlerësimin për politikën monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë dhe për kontributin e rëndësishëm të saj në stabilitetin monetar e financiar. Gjithashtu, ata nënvizuan rolin pozitiv të regjimit të lirë të kursit të këmbimit në amortizimin e goditjeve, si dhe vlerësuan punën mbikëqyrëse e rregullatore të Bankës së Shqipërisë, si dhe ndikimin e saj në treguesit pozitivë të sektorit bankar.

Në përfundim të takimit, ata konfirmuan marrëdhëniet shumë të mira të bashkëpunimit mes dy institucioneve, në kuadër të misioneve të FMN-së, asistencës teknike dhe më gjerë.

GUVERNATORI SEJKO PRET DELEGACIONIN E BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)

14 nëntor 2024, Tiranë

Më 14 nëntor 2024, Guvernatori Sejko priti në takim përfaqësuesit e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kryesuar nga z. Christoph Denk, Drejtor i Politikave Strategjike, z. Piotr Jacek Szpunar, Drejtor rajonal për Poloninë, Bullgarinë dhe Shqipërinë, si dhe zj. Ekaterina Solovova, Përfaqësuese Rezidente e BERZH-it në Shqipëri.



Gjatë takimit, Guvernatori vlerësoi asistencën e BERZH-it në mbikëqyrjen bankare, stabilitetin financiar dhe përafrimin e kuadrit rregullator me standardet e BE-së, si dhe kontributin në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, si energjia e rinovueshme, transporti dhe bujqësia. Ai i informoi përfaqësuesit mbi

zhvillimet ekonomike dhe reformat në sistemin financiar e bankar, përfshirë masat për digjitalizimin e pagesave dhe aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në zonën SEPA.



Nga ana e tyre, përfaqësuesit e BERZH-it vlerësuan politikën monetare të Bankës së Shqipërisë dhe fleksibilitetin e kursit të këmbimit, si faktorë me rëndësi në ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe fuqizimin e sektorit bankar, si dhe inkurajuan autoritetet shqiptare të vijojnë reformat strukturore, për përshejtimin e integritimit në Bashkimin Evropian. Ata mbështetën vijimin e kësaj filozofie administrimi ekonomik edhe në të ardhmen, duke theksuar rëndësinë e një banke qendrore profesionale, të përgjegjshme dhe e pavarur, për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

ZËVENDËSGUVERNATOREJA E PARË, ZJ. LULJETA MINXHOZI, NË KOMISIONIN PËR EKONOMINË DHE FINANCAT; OPINIONI I BANKËS SË SHQIPËRISË MBI PROJEKTBUXHETIN E VITIT 2025

15 nëntor 2024, Tiranë

Në datën 15 nëntor 2024, Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi, mori



pjesë në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, ku shprehu opinionin e Bankës mbi Projektbuxhetin e vitit 2025. Ndër të tjera, ajo theksoi rëndësinë e diskutimeve publike për miratimin e buxhetit, duke i konsideruar ato si një mjet të rëndësishëm për hartimin e një buxheti optimal dhe për ndërtimin e konsensusit të gjerë mes aktorëve institucionalë dhe grupeve të interesit. Zj. Minxhozi përshëndeti gjithashtu Projektbuxhetin e vitit 2025, duke e vlerësuar atë si një kuadër realist me parashikime makroekonomike dhe fiskale të konsistencës së lartë, që promovon një politikë fiskale konsoliduese dhe mundëson rritjen e investimeve publike për zhvillimin afatgjatë të vendit.



Gjithashtu, ajo theksoi se sfidat fiskale të së ardhmes, si qëndrueshmëria afatgjatë e financave publike dhe rritja e eficiencës së tyre, kërkojnë vëmendje të vazhdueshme. Në lidhje me strukturën e financimit të deficitit, Zëvendësguvernatorja theksoi mbështetje

për zhvendosjen e huamarrjes në tregun e brendshëm, për të siguruar që sektori bankar të ketë mundësinë të financojë sektorin privat. Në përfundim të fjalës së saj, Zëvendësguvernatorja Minxhozi shprehu sugjerimet dhe rekomandimet në emër të Bankës së Shqipërisë, në interes të ruajtjes dhe konsolidimit të qëndrueshmërisë së financave publike.

GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN E ORGANIZUAR NGA BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME RASTIN E 25-VJETORIT 15 nëntor 2024, Prishtinë

Më 15 nëntor 2024, Guvernatori Sejko mori pjesë në konferencën e nivelit të lartë të organizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, me rastin e 25-vjetorit të saj. Konferenca, e mbajtur në Prishtinë, trajtoi rëndësinë e integritimit në SEPA dhe ndikimin e tij në përfshirjen financiare dhe rritjen ekonomike.



Gjatë sesionit të tretë të konferencës, në të cilin Guvernatori Sejko ishte folës, u diskutua mbi rolin e ndërmjetësitimit financiar në sektorin bankar të Ballkanit Perëndimor dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik rajonal. Guvernatori



theksoi rëndësinë e modernizimit të sistemeve të pagesave dhe bankingut digjital për të nxitur përfshirjen financiare dhe efikasitetin e tregut financiar. Sistemet e pagesave janë shtylla

kurriore e tregut financiar dhe ekonomisë në tërësi, kështu që siguria dhe efikasiteti i tyre janë vendimtare për rritjen e ndërmjetësimit financiar.

GUVERNATORI SEJKO ZHVILLON NJË TAKIM ME EKIPI E BANKËS BOTËRORE

18 nëntor 2024, Tiranë

Në datën 18 nëntor 2024, Guvernatori Sejko priti në takim një ekip të Bankës Botërore (BB), në kuadër të misionit të tyre për Programin e Remitancave dhe Pagesave 2.0, të kryesuar nga z. Asad Alam, Drejtor Rajonal për Zhvillimin Gjithëpërfshirës, Financat dhe Institucionet për Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore, i cili shoqërohej nga: z. Emanuel Salinas, Përfaqësues rezident i BB-së në Shqipëri dhe z. Richard Record, Menaxher i Departamentit për Zhvillimin Gjithëpërfshirës, Financat dhe Institucionet për Vendet e Ballkanit Perëndimor.



Në krye të takimit, Guvernatori Sejko prezantoi panoramën ekonomike të vendit, duke u shprehur se ekonomia shqiptare dhe treguesit kryesorë të stabilitetit ekonomik, monetar e financiar të saj, janë në një trend pozitiv zhvillimi. Gjithashtu, Guvernatori diskutoi lidhur me një ndër objektivat strategjike të Bankës

së Shqipërisë, modernizimin e sistemeve të pagesave. Nga pikëpamja integruese e vendit, anëtarësimi i përsheptuar në SEPA garanton trajtimin e shtetasve shqiptarë si të barabartë me ata evropianë, duke sjellë për ta kosto më të ulëta dhe shpejtësi më të lartë në kryerjen e pagesave. Një tjetër aspekt pozitiv i tij është edhe ulja e informalitetit si dhe zgjerimi i përfshirjes financiare.



Z. Alam përgëzoi Bankën e Shqipërisë lidhur me menaxhimin me sukses të krizave të viteve të fundit. Ai e vlerësoi politikën monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë si një kontribut të rëndësishëm në ecurinë pozitive të ekonomisë së vendit, duke theksuar se normalizimi i kujdesshëm i qëndrimit të politikës monetare ka ndikuar në reduktimin e inflacionit.

ORGANIZOHET WORKSHOP-I I 18-TËI KËRKIMEVE EKONOMIKE TË EVROPËS JUGLINDORE 19-20 nëntor 2024, Tiranë

Në datat 19-20 nëntor 2024, Banka e Shqipërisë organizoi Workshop-in e 18-të të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore, një aktivitet shkencor që ka shërbyer si platformë për diskutimin e projekteve kërkimore të Bankës së Shqipërisë gjatë

vitet 2024. Gjatë dy ditëve të punimeve, u prezantuan mbi 25 materiale studimore, 8 prej të cilave kishin për autorë punonjës të Bankës së Shqipërisë.



Aktiviteti u hap me fjalime nga Guvernatori Gent Sejko dhe Ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, Ruth Huber, të cilët theksuan rëndësinë e këtij Workshop-i për avancimin e kërkimit ekonomik dhe përforcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Guvernatori Sejko theksoi se ky Workshop vjen në një moment të rëndësishëm, pasi ekonomia globale po përballlet me pasiguri të shtuara,

përfshirë inflacionin, normat e interesit, pasigurinë politike dhe institucionale. Ai diskutoi gjithashtu ndryshimet strukturore në ekonominë shqiptare, duke përmendur rritjen e shpejtë të turizmit, ndryshimet demografike dhe integrimin në BE.



Në fjalën e saj, Ambasadorja Ruth Huber theksoi rolin kyç të bankave qendrore në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik. Ajo inkurajoi bankat qendrore të përdorin kërkimin ekonomik për të udhëhequr politikën monetare dhe për të krijuar strategji afatgjata që mbështesin përfshirjen financiare dhe qëndrueshmërinë ekonomike në rajon dhe më gjerë.

KONFERENCA E PËRBASHKËT PËR SHTYP ME SHEFEN E MISIONIT TË FMN-SË DHE MINISTRIN E FINANCAVE

21 nëntor 2024, Tiranë

Në datën 21 nëntor 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në konferencën e përbashkët për shtyp me Shefen e Misionit të FMN-së dhe Ministrin e Financave, në kuadër të konsultimeve periodike mbi Artikullin IV. Diskutimet u fokusuan në analizën e zhvillimeve ekonomike, monetare dhe financiare të vendit, si dhe

në ndërtimin e politikave për një zhvillim të qëndrueshëm.



Guvernatori Sejko theksoi se ekonomia shqiptare po zhvillohet pozitivisht, siç dëshmohet nga rritja ekonomike dhe përmirësimi i stabilitetit financiar. Ai vlerësoi rolin e Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e këtij stabiliteti dhe në nxitjen e zhvillimit afatgjatë të vendit. Më tej, Guvernatori nënvizoi ndikimin e rëndësishëm të anëtarësimit të Shqipërisë në SEPA dhe shprehu pritshmëri pozitive për të ardhmen, duke parashikuar një rritje ekonomike prej 3.5-4% dhe inflacion të kontrolluar brenda objektivit prej 3% në vitin 2025.

Në përfundim, Guvernatori vlerësoi reformat rregullatore dhe institucionale në kuadër të integritimit në BE, duke theksuar angazhimin e Bankës së Shqipërisë për të vijuar me profesionalizëm dhe transparencë në përmbushjen e misionit të saj.

GUVERNATORI SEJKO TAKON AMBASADORIN E DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI, SH.T.Z SILVIO GONZATO

21 nëntor 2024, Tiranë

Në datën 21 nëntor 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, priti në një takim kortezie në Bankën e Shqipërisë, Ambasadorin e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, SH.T.Z Silvio Gonzato. Gjatë takimit, Guvernatori shprehu mirënjohjen për hapjen zyrtare të negociatave për Grup-Kapitullin e parë me BE-në, një moment historik për integrimin e Shqipërisë.



Gjithashtu, Guvernatori falënderoi z. Gonzato për asistencën teknike që BE-ja ka dhënë për forcimin e kapaciteteve të Bankës së Shqipërisë nëpërmjet fondeve IPA dhe programeve Twinning. Ai e njohu bashkëbiseduesin me panoramën ekonomike në Shqipëri, ku theksoi se pavarësisht

situatave sfiduese, ecuria ekonomike në vend paraqitet e qëndrueshme dhe me tregues mjaft të mirë. Fokusi i politikave ekonomike gjatë kësaj periudhe ka qenë i orientuar drejt ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, duke përshtatur qëndrimin e politikës monetare, si një parakusht për ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit tonë dhe garantimin e stabilitetit të çmimeve në vend.



Ambasadori konfirmoi angazhimin e BE-së për të vijuar mbështetjen ndaj Bankës së Shqipërisë përmes asistencës teknike dhe projekteve të përbashkëta në të ardhmen, duke synuar forcimin e mëtejshëm të sektorit bankar dhe ekonomik të vendit. Ai e përgëzoi Guvernatorin Sejko për pranimin e Shqipërisë në zonën gjeografike SEPA nën udhëheqjen dhe koordinimin e Bankës së Shqipërisë, si pjesë e projektit rajonal "Për modernizimin e sistemeve të pagesave në vendet e Ballkanit Perëndimor". Me këtë anëtarësim, Banka e Shqipërisë përmbush me sukses një ndër ambiciet e saj kryesore në kuadër të procesit të integritimit evropian.

MBLEDHJA E DHJETË VJETORE E KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË PAGESAVE

5 dhjetor 2024, Tiranë

Më 5 dhjetor 2024, u zhvillua mbledhja e 10-të vjetore e Komitetit Kombëtar të Sistemit

të Pagesave (KKSP), e drejtuar nga Kryetarja Luljeta Minxhozi. Guvernatori Gent Sejko hapi aktivitetin duke theksuar se dhjetëvjeçari i fundit ka sjellë një transformim të madh në sistemin e pagesave të Shqipërisë, duke e digjitalizuar dhe modernizuar atë. Ai foli për dy arritje kyçe: pranimin e Shqipërisë në zonën SEPA dhe operacionalizimin e bankingut të hapur, që ofron mundësi më të mira dhe më të shpejta për klientët.

Në mbledhje u diskutuan disa projekte prioritare, si bankingu i hapur, anëtarësimi në SEPA dhe pagesat e shpejta (Instant Payment). Nga ana tjetër, sa i përket anëtarësimit në SEPA, përtej përfitimeve dhe perspektivës që krijon ky anëtarësim, zj. Silvia Di Lillo, përfaqësuese e EPC, prezantoi edhe hapat e mëtejshëm që duhet të ndërmarrin institucionet shqiptare deri në anëtarësimin e tyre në SEPA. Gjithashtu, u diskutua për projektin e pagesave të shpejta, duke u fokusuar në hapat për implementimin e sistemit TIPS, një iniciativë e cila pritet të përmirësojë akoma më tej shërbimet e pagesave në vend.

GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN ME TEMË “PERSPEKTIVAT E ZHVILLIMIT EKONOMIK, GLOBALIZIMI, TURIZMI DHE TRADITA”, UNIVERSITETI “LUARASI” **12 dhjetor 2024, Tiranë**

Në datën 12 dhjetor 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Konferencën e organizuar nga Universiteti Luarasi, me temë “Perspektivat e zhvillimit ekonomik, Globalizimi, Turizmi dhe Tradita”.



Në fjalën e tij, Guvernatori vlerësoi qëndrueshmërinë e ekonomisë shqiptare gjatë periudhës së sfidave të mëdha, si pandemia, lufta në Ukrainë, dhe kriza energjetike. Pavarësisht këtyre goditjeve, Shqipëria ka arritur të ruajë stabilitetin ekonomik dhe financiar dhe të përshpejtojë ritmin e rritjes ekonomike, duke përfshirë zhvillimin e sektorit të turizmit, që e rendit Shqipërinë të tretën në botë për rritjen më të shpejtë të turizmit në vitin 2023.



Guvernatori theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë midis sektorit publik, atij privat dhe akademisë për të adresuar sfidat dhe mundësitë që krijon mjedisi global i kompleksitetit ekonomik. Ai përgëzoi Universitetin “Luarasi” për kontributin e tij në edukimin e brezit të ri dhe për rolin e tij në krijimin e një institucioni prestigjioz të edukimit profesional.

MBI TAKIMIN E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. GENT SEJKO, ME GAZETARË, ANALISTË DHE DREJTUES TË MEDIAS GJATË AKTIVITETIT “ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2024” 16 dhjetor 2024, Tiranë

Në datën 16 dhjetor 2024, Guvernatori Sejko zhvilloi një takim me publicistë të njohur, analistë, gazetarë të njohur dhe përfaqësues të shtypit të shkruar e medias elektronike në Shqipëri.



Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të Guvernatorit Sejko, i cili fillimisht falenderoi përfaqësuesit e medias për pasqyrimin me



realizëm dhe vërtetësi të të gjithë aktivitetit të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2024, përfshirë dhe vendimmarrjen e saj në fushën e politikës monetare. Banka e Shqipërisë në vazhdimësi do të jetë një partner luajal i botës mediatike, duke garantuar një komunikim transparent dhe të shpejtë, të stilizuar në një gjuhë të thjeshtë dhe lehtësisht të perceptueshme nga ana e publikut të gjerë.



Në vijim të këtij aktiviteti, siç është traditë, u ndanë edhe tre çmimet e konkursit të hapur “Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2024”. Ky konkurs organizohet prej 18 vjetësh nga Banka e Shqipërisë dhe vlerëson çdo vit tre temat më të mira të përgatitura nga studentë shqiptarë të diplomuar brenda dhe jashtë vendit në fushën e ekonomisë dhe financës. Për vitin 2024 temat trajtonin objektivat dhe politikat tradicionale të bankave qendrore, por edhe çështjet që kanë dominuar aktivitetin e BSH-së gjatë vitit 2024, pa lënë mënjanë problematikat lidhur me ndryshimet klimatike, edukimin dhe përfshirjen financiare të popullatës dhe sistemet e pagesave.





GUVERNATORI SEJKO NË MBRËMJEN E VITIT TË RI TË SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE

18 dhjetor 2024, Tiranë

Në datën 18 dhjetor 2024, Guvernatori Sejko ishte i ftuar në takimin e përvitshëm që organizon Shoqata Shqiptare e Bankave me rastin e festave të fundvitit.



Në fjalën e tij përshëndetëse, ai bëri një ekspozë të situatës ekonomike të vendit. Ekonomia shqiptare vijoi të shënojë rritje, të gjenerojë vende të reja pune dhe të përmirësojë thuajse të gjithë ekuilibrat e brendshëm e të jashtëm. Paralelisht me të, punësimi dhe pagat kanë ardhur në rritje, inflacioni është në një trend të qartë rënës, borxhi publik dhe ai i huaj janë reduktuar, bilanci i shkëmbimeve tregtare e financiare me jashtë ka shënuar një progres të dukshëm dhe bilancet e sektorit bankar paraqiten të shëndetshme.

Guvernatori theksoi se perspektivat e zhvillimit të vendit mbeten solide e pozitive. Parashikimet e Bankës së Shqipërisë, sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të vijojë të shënojë rritje, si në horizontin afatmesëm ashtu edhe në atë afatgjatë. Për më tepër, procesi i integritimit evropian ofron oportunitete materiale për një hap cilësor në zhvillimin ekonomik të vendit.

TË TJERA

Mbi hedhjen në qarkullim të monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor, me vlerë nominale 100 Lekë, emetim i vitit 2023

Më datë 15 nëntor 2024, u hodhën në qarkullim monedhat metalike shqiptare me vlerë nominale 100 Lekë, me kurs ligjor, emetim i vitit 2023, të cilat do të përdoren si mjet pagese paralelisht me të gjitha monedhat

metalike ekzistuese në qarkullim të kësaj prerjeje, emetime të viteve të mëparshme.



Këto monedha kanë të njëjtën përbërje, pamje, përmasë dhe peshë me emetimin e fundit të kësaj prerjeje, por ndryshon viti i emetimit i shtypur në trupin e monedhës metalike, i cili në monedhat e reja do të jetë "2023", si dhe drejtshkrimi i fjalëve "LEKË", "MBRETËRESHA" dhe "SHQIPËRISË".

"NETËT E MUZEUT" 2024

Muzeu i Bankës së Shqipërisë, në kuadër të programit "Netët e Muzeut," organizon çdo vit një seri leksionesh të hapura që sjellin para publikut personalitete të spikatura në fusha të ndryshme si: historia e parasë dhe bankës, ekonomia, financa dhe edukimi financiar, numizmatika; si dhe disiplina si filatelia, arti dhe arkitektura etj. Përmes këtyre aktiviteteve, Banka e Shqipërisë synon të krijojë një mjedis ku publiku jo vetëm njihet me ekspozitat e tij, por edhe shkëmben ide dhe përfshihet në diskutime të frytshme mbi temat e trajtuara.



Në datën 24 tetor 2024, u zhvillua leksioni i parë nga Prof. Assoc. Dr. Selami Xhepa, me temë "Inflacioni dhe ndikimi në koston e jetesës". Lекtori diskutoi me dëgjuesit, arsyet e rritjes së çmimeve, ndikimin në fuqinë blerëse dhe masat që mund të ndërmerren për të mbrojtur financat personale. Ky leksion shërbeu për të ndërgjegjësuar publikun e gjerë dhe kryesisht të rinjtë mbi domosdoshmërinë e politikave të kujdesshme monetare për ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe mbrojtjen e mirëqenies së qytetarëve.



Leksioni i radhës u mbajt në datën 30 tetor 2024, nga Prof. Niko PANO, me temë "Psikologjia e parasë dhe rritja personale". Profesor Pano e përqëndroi prezantimin e tij në çështje kyçe të sjelljes financiare dhe zhvillimit personal, duke shtjelluar ndikimet e sjelljes, përvojave personale dhe vendosjes së qëllimeve afatgjata financiare në lidhje me suksesin financiar. Leksioni u ndal edhe në konceptet e "mjaftueshmërisë" dhe "lirisë ekonomike" që mund të ndihmojnë në arritjen e një qëndrueshmërie financiare.

EKSPOZITA EDUKATIVE "MONEY SMART – EDUKIM FINANCIAR PËR TË GJITHË"

Ekspozita "MONEY smART – Edukim financiar për të gjithë" është fryti i parë i Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare, e miratuar në fillim të vitit 2024, si dëshmi e angazhimit serioz të Bankës së Shqipërisë në këtë fushë. Kjo



ekspozitë, e çelur fillimisht për publikun kryeqytetas në majin qershor, në muajt tetor-nëntor 2024, vizitoi Korçën dhe Shkodrën.

Duke e ndërthurur me ekspozitën MONEY smART, Muzeu i Bankës së Shqipërisë dhe Qendra Muzeore Durrës prezantuan ekspozitën fotografike mbi aspektet më të spikatura të zhvillimeve arkeologjike, arkitekturore, tregtare dhe ekonomike të qytetit të Durrësit. Kjo ekspozitë u mbajt në qytetin bregdetar të Durrësit në datat 7-8 nëntor 2024.

BANKA E SHQIPËRISË I KOMUNIKON PUBLIKUT VENDIMMARRJEN E POLITIKËS MONETARE

Pas çdo mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë i komunikon publikut në një konferencë për shtyp vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë. Kështu, gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2024, janë zhvilluar pesë konferenca për shtyp, përkatësisht më: 3 korrik, 7 gusht, 2 tetor, 6 nëntor, 18 dhjetor. Në këtë periudhë, politika



monetare është lehtësuar dy herë dhe norma bazë e interesit u ul nga 3.25% deri në nivelin 2.75%.



Gjithashtu, gjatë konferencave komunikohet edhe ndryshimi i normës së interesit të depozitës dhe kredisë njëditore, të cilat janë ulur përkatësisht nga 2.25% në nivelin 1.75% dhe nga 4.25% në nivelin 3.75%, për të njëjtën periudhë.

PREZANTIMET E RAPORTEVE PERIODIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË, PËR MEDIAN

Si pjesë e strategjisë së komunikimit me publikun, Banka e Shqipërisë organizon prezantimin e raporteve të saj periodike për median, përpara publikimit të tyre. Bazuar në kalendarin e publikimit të raporteve periodike të publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, në fillim të vitit 2024, gjatë



6-mujorit të dytë të këtij viti, janë zhvilluar 3 prezantime "off the records" për mediat:

1. Prezantimi i Raportit të Politikës Monetare 2024/III, në datën 15 gusht 2024;
2. Prezantimi i Raportit të Stabilitetit Financiar 6-mujori I 2024, në datën 19 shtator 2024;
3. Prezantimi i Raportit të Politikës Monetare 2024/IV, në datën 12 nëntor 2024.



Këto takime organizohen ditën e publikimit të raporteve përkatëse në faqen e internetit. Ato synojnë orientimin e medias në leximin e drejtë të vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë dhe vlerësohen si një mjet mjaft efikas komunikimi.

AKTIVITETE HUMANITARE TË PUNONJËSVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në datën 13 dhjetor 2024, në ambientet e Bankës së Shqipërisë u organizua një aktivitet humanitar nga fshati "SOS" dhe Fondacioni "Down Syndrome Albania". Në këtë aktivitet, punonjësit e Bankës së Shqipërisë blenë kartolina urimi për festat e fundvitit me vizatime të fëmijëve, si dhe lule krishtlindjesh. Fondet e mbledhura nga shitja e tyre shkuan në ndihmë të fëmijëve të fshatit "SOS" dhe për të siguruar terapi pa pagesë për individët me sindromën Down.



